



Match-Maker Albania

Find the right match, Unlock the opportunity

MATCH MAKER ALBANIA 2025, EVENTI MË I MADH I VITIT PËR BIZNESIN!

Match Maker Albania - Ngjarja më e madhe vjetore për biznesin!

Eventi Match Maker Albania u zhvillua përgjatë gjithë ditës, në datën 27 mars, në Pallatin e Kongreseve. Aktiviteti më i madh i biznesit për vitin 2025, në vendin tonë u përshëndet nga Kryeministri, Z. Edi Rama dhe Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z. Blendi Gonxhja. Aktivitetin e çeli Znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s, institucioni organizues i këtij aktiviteti gjithpërfshirës për sektorin e ekonomisë, biznesit dhe investimeve.

-Kryeministri Z.Edi Rama përshëndeti duke theksuar se kjo është koha më e mirë për të investuar në Shqipëri. "Jemi një vend shumë i mirë për të investuar në gjithçka. Një vend shumë i mirë po ashtu për t'u bërë bashkë, qofshi aktorë lokalë dhe aktorë ndërkombëtarë të biznesit." – u shpreh ai.

-Ministri i Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Z.Blendi Gonxhja, në fjalën e mbajtur në këtë event vlerësoi pjesëmarrësit nga 37 vende të botës, duke e cilësuar këtë, "pasqyrim i qartë i interesit dhe besimit në rritje në Shqipëri, si një destinacion për investime dhe inovacion".

-Drejtoresha Ekzekutive e AIDA-s, Znj. Laura Saro, në fjalën e mbajtur, e cilësoi eventin një vendtakim të rëndësishëm ku do të diskutohen partneritetet e mundshme për investimeve në një gamë të gjerë sektorësh.

-Në një atmosferë dinamike në Pallatin e Kongreseve, u bashkuan:

- ✓ Mbi 500 investitorë të huaj
- ✓ Mbi 200 investitorë shqiptarë
- ✓ Mbi 1000 pjesëmarrës
- ✓ 30 kompani shqiptare
- ✓ 30 projekte investimi
- ✓ Përfaqësues nga 37 shtete të ndryshme

37 Shtete
Pjesëmarrëse



Gjatë këtij eventit u zhvilluan 3 panele diskutimi ku morën pjesë edhe ekspertë ndërkombëtarë dhe figura kyçe të ekonomisë shqiptare

Paneli 1:

"Investimet dhe mundësitë e tregut në Shqipëri"

Paneli 2:

"Investimi dhe zgjerimi në Ballkan"

Paneli 3:

"E ardhmja e SME-ve: Inovacioni Qëndrueshmëria dhe Dixhitalizimi"



Ky event u shënua nga takime intensive B2B & B2G, panele me ekspertë ndërkombëtarë, prezantimi i produkteve më të mira "Made in Albania", podcast-e live, workshop-e frymëzuese dhe një kalendar i pasur me ngjarje sociale dhe kulturore.

Një falënderim i madh për të gjithë pjesëmarrësit, investitorët, partnerët dhe mbështetësit që e kthyen këtë ditë në një moment historik për rrjetëzimin dhe zhvillimin ekonomik të Shqipërisë! Eventu u mbështet nga Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit dhe Enterprise Europe Network Albania.

Faleminderit që ishit pjesë e Match Maker Albania 2025!



Gjatë eventit u nënshkruan 4 Memorandume Mirëkuptimi (MoU) për nxitje të bashkëpunimit tregtar dhe investimeve mes dy vendeve

MoU midis Albanian Investment Development Agency dhe Kazakh Invest.

MoU midis Albanian Investment Development Agency dhe The United Kingdom of Great Britain dhe Northern Ireland Chamber of Commerce in Albania.

MoU midis Albanian Investment Development Agency dhe Development Agency of Serbia.

MoU midis Albanian Investment Development Agency dhe Invest North Macedonia.



Projektet e mëdha

Pjesëmarrësit e MatchMaker Albania 2025 zhvilluan takime të personalizuara B2B me kompani të interesuara dhe B2G me institucionet shtetërore për t'u njohur me zhvillimin e projekteve të mëdha private dhe publike si :

- DURANA Technopark
- EXPO Albania
- Hospitality Albania -Vlora's Villa
- Hospitality Albania -Velipoja's Villa
- The New Building of The National Library
- Lift Tower
- TEDA Tirana



Mundësi të reja për Investim

Pjesëmarrësit e MatchMaker Albania 2025 patën takime të personalizuara B2B me kompani të interesuara dhe B2G me institucionet shtetërore për t'u njohur me zhvillimin e projekteve të mëdha private dhe publike si:

- Lëkurësi - TDT & Partners
- Residence & Hotel Rozafa
- Marina Orikum dhe San Pietro - Concord Investment
- Lajthiza Agroturism
- Green Coast - Balfin Development
- Grand Park Skyline - Planet Plein
- Vertigo Free Zone - Durrës Industrial Park



Brandet Ndërkombëtare të Hotelerisë pjesë e eventit

Patëm kënaqësinë të ishin pjesë në aktivitetin tonë prestigjioz:

- Marriott
- Melia
- Movenpick
- Mercure
- Maritim
- Radisson Blu
- Stone Beach by KOMITETI
- Hilton Garden Inn



Takime B2G në Match Maker Albania 2025 me institucionet

- Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
- Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
- Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
- Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- Ministria e Mbrojtjes



News Room

Në këtë event u bashkuan me ne disa media partner për të sjellë nga afër atmosferën, diskutimet në panele dhe për të na shoqëruar gjatë gjithë ditës së aktivitetit.



AIDA mori pjesë në panairin më të madh të turizmit në botë, në ITB Berlin

Me 190 vende pjesëmarrëse dhe 5.600 ekspozues, Shqipëria mori titullin e "Vendit të Nderit" në ITB Berlin.

Në ditën e parë të panairit më të madh të turizmit në botë, Shqipëria mirëpriti në stendën e saj vizitorë dhe investitorë në fushën e infrastrukturës aeroportuale dhe turizëm. AIDA, si institucion kyç për tërheqjen e investimeve, shfaqti mundësitë për investime në turizëm.

ITB Berlin është një ngjarje që tërheq shumë ekspozues dhe pjesëmarrës globalë, duke mbetur një platformë kryesore për rrjetëzim, inovacion dhe turizëm. Ai luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në formësimin e trendeve, politikave dhe partneriteteve në sektorin e turizmit.



Znj. Laura Saro, në intervistën e dhënë për "The Forbes", në Panairin e Turizmit në Berlin (ITB)

Drejtoresha e AIDA-s, Znj. Laura Saro, në intervistën e dhënë për "The Forbes", veçoi se në Panairin e Turizmit në Berlin (ITB) këtë vit, AIDA prezantoi Shqipërinë si një destinacion kryesor investimi për turizmin, energjinë, infrastrukturën dhe zhvillimin e qëndrueshëm.

Strategjia jonë, thekson ajo, fokusohet në tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë, promovimin dhe zhvillimin e sektorit të turizmit në Shqipëri dhe nxitjen e partneriteteve me aktorët globalë.

Për më shumë shfletoni në link:

https://www.forbes.at/files/Werbung/itb-berlin_final-report.pdf

Forbes

ITB Berlin 2025: A Transformative Event for the Future of Travel



AIDA prezantoi Shqipërinë në ITB Berlin si një destinacion kryesor investimi për turizmin, energjinë, infrastrukturën dhe zhvillimin e qëndrueshëm.


Ekspteri i njohur i FOCUS-online, Thomas Druyen Shqipëria – Nga një perlë e fshehur në magnetin e ardhshëm të turizmit



Ekspteri i njohur i FOCUS-online, Thomas Druyen Shqipëria – Nga një perlë e fshehur në magnetin e ardhshëm të turizmit

Në panairin ITB të këtij viti në Berlin, Shqipëria ishte vendi zyrtar i ftuar dhe la një përshtypje të fortë tek vizitorët me diversitetin e saj.

Studiuesi i së ardhmes, Thomas Druyen, shpjegon sesi një vend në transformim mund të bëhet magneti turistik i Europës.



Forumi i Biznesit Shqipëri-Francë

AIDA, në bashkëpunim me Ambasadën Franceze në Shqipëri, organizoi Forumin e Biznesit Shqipëri-Francë, me pjesëmarrjen e një delegacioni të rëndësishëm nga MEDEF International, kryesuar nga Z. Christophe Petit.

Kompanitë elitare franceze nga ky delegacion, shprehën interes për bashkëpunime në Shqipëri, ndërsa investimet franceze kanë njohur rritje përgjatë viteve të fundit, duke e renditur Francën në vendin e 7-të të kontribuesve të Investimeve të Huaja Direkte në Shqipëri.

Paneli i diskutimit mblodhi figura kyçe të ekonomisë shqiptare:

- ✓ Znj. Delina Ibrahimaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë
- ✓ Znj. Blerta Rama, Zëvendësministre e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit
- ✓ Znj. Laura Saro, Drejtore Ekzekutive e AIDA-s
- ✓ Znj. Florenca Haxhi, CEO e Durana-Tech Park, AIC
- ✓ Z. Gentjan Kerri, Zëvendës CEO i Fondit Shqiptar të Zhvillimit
- ✓ Z. Dritan Delija, CEO i TEDA Tirana

Sh.S.Znj. Catherine Suard, Ambasadore e Francës në Shqipëri, prezantoi delegacionin francez dhe shprehu gadishmërinë e palëve për bashkëpunim sa më frytdhënës.

Gjatë forumit u prezantuan potencialet e bashkëpunimit ekonomik mes dy vendeve dhe roli i Shqipërisë si një destinacion atraktiv për investime, ku delegacioni pati mundësinë e drejtitimit të pyetjeve konkrete për panelistët.

Në vijim, u zhvilluan takime B2B mes bizneseve shqiptare dhe franceze, duke hapur rrugën partneriteteve dhe mundësi të reja.



MIPIM 2025 u zhvillua në datat: 10-14 Mars 2025, në Palais des Festivals, Cannes, Francë

AIDA përmbylli me sukses panairin ndërkombëtar të pasurive të paluajtshme MIPIM 2025.

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë për herë të parë në MIPIM 2025, panairin më të rëndësishëm ndërkombëtar të pasurive të paluajtshme, duke prezantuar projekte të mëdha urbanistike dhe mundësi investimi në Shqipëri. MIPIM mbledh liderët e pasurive të paluajtshme nga e gjithë bota, duke përfshirë investitorë, zhvillues, arkitektë, urbanistë dhe përfaqësues të autoriteteve publike.

AIDA prezantoi në pavionin e saj 4 projekte të rëndësishme të 4 kompanive të sektorit të pasurive të paluajtshme:

- Concord Investment,
- TDT & Partners,
- Rozafa-A,
- E&A Investment.

-Në Festivalin Urban Ndërkombëtar MIPIM 2025 morën pjesë:

- + 6,500 Investitorëve
- + 2,500 Kompani Ekspozuese
- + 90 Shtete të Përfaqësuar
- + 1,000 Aktorë të Sektorëve Kryesorë
- + 400 Pjesëmarrës në Konferenca dhe Evente Rrjetëzimi
- + 500 Folës të Shquar
- + 20,000 Pjesëmarrës nga e gjithë bota

Pesë ditë dinamike të mbushura me rrjete, konferenca dhe diskutime kyçe nga partnerët tanë me fokus Invest in Albania.

Stenda e AIDA-s u vizitua nga shumë investitorë, urbanistë dhe nga studio ndërkombëtare arkitekturore, që vlerësuan Shqipërinë dhe zhvillimin që po ndodh vitet e fundit.



MIPIM-Marrëveshje e re për promovimin e tregut shqiptar të pasurive të paluajtshme midis AIDA dhe MIAMI ASSOCIATION of REALTORS

Në ditën e dytë të pjesëmarrjes në MIPIM 2025, Drejtoresha Ekzekutive e AIDA, znj. Laura Saro, nënshkroi një Marrëveshje me Miami Association of REALTORS, e cila do të ndihmojë në promovimin e Shqipërisë si një destinacion tërheqës për investime në sektorin e pasurive të paluajtshme.

Kjo marrëveshje do të krijojë mundësi të reja bashkëpunimi, shkëmbimi informacioni dhe promovimi të tregut tonë në një rrjet global profesionistësh të pasurive të paluajtshme në MAIAMI dhe më gjerë.

MIAMI ASSOCIATION of REALTORS përfaqëson rreth 60 000 profesionistë të fushës dhe ka marrëveshje me 279 organizata ndërkombëtare të këtij sektori në mbi 70 vende të botës.

Një tjetër hap i rëndësishëm ky, për tërheqjen e investitorëve ndërkombëtarë në Shqipëri!



AIDA në Expo Food 2025, 14-16 Mars, Athinë

AIDA mori pjesë për herë të dytë në këtë panair ndërkombëtar me 6 kompani të shkëlqyera shqiptare. Food Expo 2025 është një mundësi e shkëlqyer për të eksploruar risitë dhe tendencat e fundit në industrinë e ushqimit dhe pijeve.

Në kuadër të Food Expo Athinë, një nga panairët më të mëdha të industrisë ushqimore në rajon, Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) organizoi një takim me Unionin Grek të Shitësve me Shumicë (UGW – Union of Greek Wholesalers).

Ky takim synon të lehtësojë hyrjen e produkteve shqiptare në tregun grek dhe të forcojë bashkëpunimin ekonomik mes dy vendeve.

Përfaqësues të AIDA-s dhe UGW diskutuan mbi mundësitë konkrete për shpërndarjen e produkteve shqiptare në rrjetet greke të shitjes me shumicë, duke identifikuar kategori të vecanta me potencial eksporti.

Ky është një moment i rëndësishëm për të forcuar praninë e bizneseve shqiptare në rajon dhe për të ndërtuar partneritete afatgjata me distributorët grekë.

Stenda shqiptare, u vizitua nga përfaqësues të Agjencisë së Tregtisë dhe Investimeve, të Polonisë. Znj. Kinga Majchrzak pati mundësinë të takojë me secilën kompani në stendë duke shkëmbyer eksperincat dhe kontaktet si dhe duke u njohur nga afër me profilin e secilit biznes.

Ambasadorja e Republikës së Shqipërisë në Greqi, znj. Luella Hajdaraga, vizitoi stendën shqiptare në Expo Food 2025, duke shprehur mbështetjen e saj për përfaqësimin e produkteve shqiptare në këtë ngjarje të rëndësishme.

Gjatë vizitës, ajo u takua me stafin e AIDA dhe me përfaqësuesit e gjashtë kompanive shqiptare pjesëmarrëse, të cilat prezantuan një përzgjedhje cilësore të verërave, bimëve mjekësore dhe aromatike, si dhe kafesë.



Mbledhja Steering and Advisory Group (SAG) u zhvillua në datat 11-12 Mars në Bruksel

AIDA pati kënaqësinë të ishte pjesë e këtij takimi në bashkëpunim me EEN Albania ku u zhvilluan diskutime dhe ide të rëndësishme për të ardhmen e rritjes dhe mbështetjes së SME-ve.

Më 11 Mars 2025, EEN Albania mori pjesë në takimin e parë të Steering and Advisory Group (SAG) ku u diskutua mbi:

- ◆ Politikat dhe përditësimet e EEN.
- ◆ Strategjinë e Tregut të Përbashkët.
- ◆ Barrierat në tregun e përbashkët.
- ◆ Startup-et dhe rritjen e bizneseve.
- ◆ Sfidat e SME-ve dhe feedback-un operacional nga SAG Bureau.
- ◆ Sinergjitë midis EEN dhe EIT/EIC/EUREKA.
- ◆ Workshop-in mbi kalimin e të dhënave të sistemit IT në kontratën e re dhe përkufizimin e Arritjeve Këshillimore (AA).
- ◆ Prioritetet e Platformës IT për vitin 2025.

Ftesë për pjesëmarrje në panairin “RIGA FOOD”, 04-06 Shtator 2025

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), po organizon për herë të parë pjesëmarrjen me stendë të Shqipërisë në panairin “RIGA Food”, që do të zhvillohet në datat 04-06 Shtator 2025, në Riga, Letoni. RIGA FOOD, është një panair dedikuar sektorit “Pije&Ushqim”, ku profesionistët e industrisë ushqimore nga vendet e BE-së dhe të tjera, takohen çdo vit për të promovuar bizneset e tyre dhe për të mësuar rreth zhvillimeve më të fundit të industrisë ushqimore. Pjesëmarrja e kompanive në këtë panair synon të nxisë eksportet e produkteve shqiptare, të rrisë shkëmbimet tregtare midis dy vendeve por dhe më gjerë.

Në edicionin e vitit të kaluar morrën pjesë 425 kompani që përfaqësojnë rreth 32 vende dhe mbi 20,000 vizitorë ku 50 % e tyre ishin profesionistë ndërkombëtarë të industrisë ushqimore.

Panairi ka në fokus produktet e mishit, qumështit, peshkut, bukës, ushqimet e ngrira, ushqimet e freskëta, fruta-perime, ushqime të përpunuara, pijet alkoolike dhe joalkoolike, produktet vegjetariane, vegane, organike, hallall, etj.

Tarifa e regjistrimit për çdo kompani pjesëmarrëse në stendë do të jetë 99.00 euro pa TVSH.



Për më shumë informacion rreth këtij panairi, lutem konsultoni linkun: <https://www.btl.lv/rigafood/eng/visit.php>

Kompanitë e interesuara për të qenë pjesëmarrës në këtë event, lutemi të shprehin interesin e tyre me email në adresën: info@aida.gov.al, brenda datës 04.04.2025.